



VENDIM

Nr. 81, Datë 30.06.2015

**PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR MIRATIMIN E RREGULLORES
MBI PROCEDURAT PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË
SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16, dhe 58 të Ligjit nr.43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike; nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.03.2009, i ndryshuar, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 30.06.2015, mbasi shqyrtoi draftin e përgatitur nga grupi i punës të Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, dhe relacionin përkatës, për fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin dhe miratimin e Rregullores për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.
Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARI i ERE-S
Petrit AHMETI**

RREGULLAT PER CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TË ENERGIJË ELEKTRIKE

KAPITULLI I - DISPOZITA TË PËRGJITHSHME

Neni 1

(Autoriteti)

Këto rregulla hartohen në baze të neneve 3, pika 8, 54, 58 dhe 59, të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Traktatit të Komunitetit të Energjisë të ratifikuar me Ligjin nr. 9051, datë 03.04.2006, Rregullat per Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE si dhe në përputhje me Direktivën 2009/72-EC si dhe Rregulloren EC Nr.741/2009.

Neni 2

(Qëllimi)

Qëllimi i kësaj rregulloreje është sigurimi i një procesi **Certifikimi** transparent, te plote, te besueshëm dhe koherent me çdo ndryshim eventual i cili garanton përputhshmërinë me kushtet që sigurojnë pavarësinë dhe ndarjen e **Operatorit të Sistemit të Transmetimit**, qe garanton ndarjen e plote nga aktivitetet e tjera te sektorit te energjise elektrike dhe gazit natyror sipas përcaktimeve të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", në funksion të zhvillimit të sektorit të energjisë elektrike ne përputhje me rekomandimet e paketës së tretë legjislative të BE, si dhe garantimin e rolit mbikëqyrës të ERE mbi aktivitetin e Operatorit te Sistemit te Transmetimit te energjise elektrike.

Neni 3

(Objekti dhe Fusha e Zbatimit për Rregullatorin)

- (1) Rregullorja për Certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit për Energjinë Elektrike (ne vijim – "Rregullorja") përcakton kërkesat procedurale për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në Shqipëri, duke përfshirë këtu kushtet dhe afatet për paraqitjen e dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve, te cilat provojnë përmbushjen e kushteve, sipas nenit 54, të Ligjit nr.43/2015, "Për

Sektorin e Energjisë Elektrike”,sikurse kërkohen nga procedurat e certifikimit te Enti Rregullator te Energjisë (ne vijim – “ERE”).

- (2) Rregullorja përcakton listën e dokumenteve, të dhënave dhe informacioneve që duhet të paraqiten nga një shoqëri elektroenergjetik e cili aplikon për tu caktuar dhe certifikuar si operator i sistemit të transmetimit në Shqipëri.
- (3) Licencimi për aktivitetet e operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike do të rregullohet nga Rregullat dhe kerkesat per dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike të miratuara nga ERE.

Neni 4

(Zbatimi dhe interpretimi i rregullores)

- (1) Rregullorja do te aplikohet për operatorin e sistemit te transmetimit te energjise elektrike te autorizuar apo çdo shoqëri e cila aplikon për caktimin e funksionimin si operator i sistemit te transmetimit te energjise elektrike.
- (2) Aplikimi i duhur i rregullores do te garantohet, monitorohet dhe mbikëqyret nga ERE.
- (3) Këto rregulla do të zbatohet për certifikimin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit, si dhe për të rivlerësuar vlefshmërinë e certifikimit në kushtet e ndryshimeve eventuale të kontrollit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit.
- (4) Rregullorja duhet të zbatohet dhe interpretohet në përputhje me dispozitat e Direktivës 2009/72-EC si dhe Rregulloren EC Nr.741/2009, Ligjit Nr. 43/2015, datë 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, (ne vijim – Ligji) aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurat e brendshme dhe organizimin e punës të ERE, përkatësisht “Rregullat e Praktikes dhe Procedurave te ERE” si dhe duke marre ne konsiderate “Udhëzimet interpretuese mbi direktivën 2009/72/EC ne lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të energjisë elektrike dhe direktivën 2009/73/EC në lidhje me rregullat e përbashkëta për tregun e brendshëm të gazit natyror, Regjimi i ndarjes se aktiviteve (Material diskutimi i Stafit te Komisionit, Bruksel, 22 Janar 2010”, “Materialin e diskutimit e Stafit te Komisionit, për certifikimin e Operatoreve te Sistemit te Transmetimit te rrjetit te energjise elektrike dhe gazit natyror ne Bashkimin Evropian, Bruksel (21.9.2011, SEC (2011) 1095 final)” dhe duke u këshilluar me Sekretariatin e Komunitetit të Energjisë (ne vijim – Sekretariati).

Neni 5

(Termet dhe përkufizime)

- (1) Të gjitha termat e përdorura në Rregullore duhet të kuptohen dhe interpretohen sikurse janë përcaktuar nga neni 3, të Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, ligje të tjera në zbatim dhe rregulloret e miratuara nga ERE.
- (2) Çdo term i përdorur në këto rregulla për të cilin nuk ekziston një përkufizim sipas pikës së mësipërme do të interpretohet në kontekstin dhe frymën e Ligjit nr.43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”.

KAPITULLI II – DETYRIMET PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

Neni 6

(Detyrimet për certifikimin)

- (1) Para se një shoqëri të miratohet dhe caktohet si Operator i Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike duke u paisuar me licencën e duhur sipas kushteve dhe afateve të përcaktuara në Ligjin 43/2015 " Per sektorin e energjise elektrke" dhe "Rregullat dhe kerkesat per dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike" të miratuara nga ERE duhet të jete e certifikuar nga ERE.
- (2) "Rregullat dhe kerkesat per dhenien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave ne sektorin e energjise elektrike" miratohen në përputhje me procedurën e parashikuar në Ligjin 43/2015 dhe në Rregulloren per Organizimin, funksionimin dhe Procedurave te ERE-s.
- (3) Detyrimet e përcaktuara në paragrafin (1) të këtij Neni duhet të zbatohen për:
 - a) operatorin e sistemit të transmetimit te energjise elektrike, i cili është autorizuar për të kryer këto aktivitete para se Ligji nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" të hynte në fuqi qe ne vijim aplikon për caktim dhe funksionim ne vazhdim te zbatimit te plotë të kërkesave te ndarjes se aktiviteteve sipas nenit 54 te Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"; ose
 - b) shoqëria, e cila plotëson kërkesat kualifikuese dhe ato për ndarjen e aktiviteteve për operatorin e sistemit të transmetimit te energjise elektrike dhe si rrjedhoje aplikon për certifikim, ose
 - c) shoqëria përgjegjëse për infrastrukturën e re të transmetimit të energjisë elektrike e cila ishte përjashtuar nga veçimi i pronësisë sipas Nenit 32 të Ligjit nr. 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"
- (4) Ndarja e aktivitetit te Operatorit të Sistemit të Transmetimit te energjise elektrike do të zbatohet sipas kushteve dhe termave të përcaktuara në Ligjit 43/15, dhe kur është e përshtatshme, sipas ligjeve dhe rregulloreve në te tjera ne fuqi.

Neni 7

(Aplikimi për certifikim)

- (1) Shoqëria e referuar në paragrafin (3) të Nenit 6 të Rregullores, (ne vijim – shoqëria aplikuese) ne vijim të zbatimit te të gjitha kërkesave për ndarjen e aktivitetit te operatorit të sistemi të transmetimit te energjise elektrike, duhet të njoftojë ERE me shkrim dhe duhet të paraqesin:
 - a)kërkesën me shkrim për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike;
 - b)dokumentet, të dhënat dhe informacionet e përmendura në Kapitullin III të Rregullores; dhe

- c) Pyetësonin e plotësuar për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, sipas modelit të dhënë në Shtojcën e kësaj Rregulloreje, përveç rasteve kur shoqëria që ka paraqitur kërkesën është OST e përjashtuar sipas Nenit 32, vendimi i përjashtimit të të cilit parashikon një model ndarje të aktivitetit që nuk përcaktohet në Ligj dhe pyetësoni duhet të hartohet nga ERE në bashkëpunim me Sekretariatit.
- (2) Kërkesa për certifikim si operator i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike duhet të paraqitet dhe po ashtu procedurat përkatëse të certifikimit duhet të kryhen në mënyrë të pavarur nga licencimi i operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
 - (3) Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike i cili dëshiron të certifikohet në kuptim të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" paraqet në ERE një kërkesë specifike me shkrim, duke përfshirë të gjithë informacionin e kërkuar nga legjislacioni në fuqi dhe ato të kërkuara nga kjo rregullore.
 - (4) Certifikimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike kryhet vetëm një herë ose në të kundërt rishikohet nëse janë kryer ndryshime thelbësore në lidhje me kontrollin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike ose zotëruesin e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të certifikuar më parë apo nëse kanë ndodhur apo parashikohet të ndodhin ndryshime të cilat cenojnë përmbushjen e kritereve të nenit 54, të Ligjit 43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" si dhe ato të përcaktuara në këto rregulla.

Neni 8

(Kriteret për certifikim)

- (1) Kriteret e mëposhtme do të udhëheqin procesin vendimmarrës të ERE për certifikimin me qëllim garantimin e ndarjes së aktiviteteve sipas përcaktimeve të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike", Direktivës 2009/72-EC, si dhe Rregulloren EC Nr.741/2009 duke siguruar një Operator të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të pavarur dhe që garanton sigurinë e furnizimit ndërkohë që përmbush të gjitha detyrimet funksionale dhe ato ndërkombëtare dhe në raport me ENTSO-E.
- (2) ERE do të ushtrojë autoritetin rregullator në mënyrë të përshtatshme dhe praktike duke ju referuar nenit 54, të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe kritere që duhet të përmbushen nga aplikuesi për të mundësuar vendimmarrjen dhe certifikimin të cilat konsistojnë si më poshtë:

- a) Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike nuk duhet të ketë të drejta kontrolli të drejtpërdrejtë apo të tërthorë në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas;
- b) Personi juridik që ka pronësinë mbi Operatorin e Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike nuk emëron, kontrollon apo është anëtar i bordeve apo strukturave drejtuese në aktivitetet e prodhimit, shpërndarjes, furnizimit apo anasjelltas si dhe nuk ushtron të drejtën e votës apo të drejtën e mazhorancës së aksioneve;
- c) Garantohet konfidencialiteti i informacionit komercial që Operatori i Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike zotëron dhe mos transferimi i stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike tek ndërmarrjet/sipërmarrjet gjeneruese apo furnizuese;
- d) Pasja në dispozicion të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike të burimeve të nevojshme financiare, teknike, fizike dhe njerëzore për të realizuar aktivitetin e tij;
- e) Angazhimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për përmbushjen e një plani 10 vjeçar zhvillimor të rrjetit i monitoruar dhe aprovuar nga rregullatori;
- f) Aftësia e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për të përmbushur detyrimet e përcaktuara në Rregulloren (EC) No. 714/2009;
- g) Kompetencat e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për dhënien dhe menaxhimin e aksesit të palëve të treta, si dhe operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit me qëllim përmbushjen afatgjatë të kërkesës nëpërmjet planifikimit të investimeve, ndërtimit dhe komisionimit e infrastrukturës përfshirë dhe procedurën e autorizimit;
- h) Mbështetjen dhe informacionin nga pronari i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike për përmbushjen e detyrave; financimin ose miratimin e financimeve të investimeve të miratuara nga rregullatori; mbulimin e detyrimeve për asetet e rrjetit; sigurimin e garancive për të lehtësuar/mundësuar financimin e zgjerimit të rrjetit;
- i) Kompetencat e Autoritetit të Konkurrencës për monitorimin e aktivitetit të pronarit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike;
- j) Pasja e aseteve të nevojshme në pronësinë e Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike, pajisjeve, stafit të punësuar si dhe të një identiteti komercial të qartë dhe të dallueshëm nga operatorët e tjerë;
- k) Organizimi sipas formave ligjore të përcaktuara nga neni 1 i Direktivës 68/151/EEC dhe kuadrit ligjor në fuqi;
- l) Sistemet IT, godinat ku ushtrohet aktiviteti i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike apo sistemeve të sigurisë dhe aksesit nuk mund të bashkë shfrytëzohen me ndërmarrje/sipërmarrje të prodhimit apo të furnizimit të integruara vertikalisht apo të kontraktuara të njëjtë ofrues të këtyre shërbimeve;
- m) Audituesi financiar i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjisë elektrike nuk mund të jetë i njëjti subjekt që kryen auditimin e ndërmarrjeve/sipërmarrjeve gjeneruese apo të furnizimit të integruara vertikalisht;

- n) Perberja dhe kompetencat e Bordit Mbikëqyrës;
- o) Garantimi i pavarësisë së Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike në vendimmarrje në lidhje me përmbushjen e detyrave të tijë si dhe në kompetencën për ngritjen e fondeve në tregun kapital nëpërmjet huamarrjes;
- p) Pavarësia e menaxhimit dhe stafit të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike bazuar në kompetencat e Bordit Mbikëqyrës të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike në lidhje me rekrutimin, kompensimin dhe përfundimin e marrëdhënieve për drejtuesit ekzekutiv apo administratën pasi ka njoftuar rregullatorin mbi procedurat që rregullojnë çështjet e mësipërme dhe nëse ky i fundit nuk ka paraqitur objeksione;
- q) Përrjashtimi i punonjëseve të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike nga e drejta e përfitimit financiar direkt apo indirekt nga shoqërite e integruara vertikalisht;
- r) Programi i përputhshmërisë dhe monitorimi i Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike nëpërmjet një linje komunikimi dhe aprovimi me rregullatorin;
- s) Kompetencat vendimmarrëse të Operatorit të Sistemit të Transmetimit të energjise elektrike për lidhjen e prodhuesve në sistem sipas procedurave të miratuara nga rregullatori.

KAPITULLI III – PARAQITJA E DOKUMENTAVE, TË DHËNAVE DHE INFORMACIONIT

Neni 9

(Lista e dokumenteve, të dhënave dhe informacionit)

(1) Shoqëria aplikuese, së bashku me kërkesën me shkrim për certifikim si operator i sistemit të transmetimit të energjise elektrike, duhet të paraqesë tek ERE dokumentet, të dhënat dhe informacionin e mëposhtëm:

- a) kopje të noterizuara të dokumenteve të themelimit dhe regjistrimit;
- b) listën e licencave, lejeve dhe/ose autorizimeve të tjera të mara nga shoqëria aplikuese për veprimtaritë në sektorin e energjisë në Shqipëri dhe/ose vende të tjera, dhe kopjet e noterizuara të këtyre licencave, lejeve dhe/ose autorizimeve të tjera;
- c) listën e aksionerëve që kanë të paktën [1/3] e totalit të aksioneve dhe/ose votave në asambljetë të përgjithshme të shoqërisë aplikues, duke treguar qartë aksionet dhe votat që ka secili nga aksionerët;
- d) listën e aksionerëve nga vendet e treta, siç mund të jetë rasti, që kanë të paktën 5% të aksioneve në total dhe/ose votave në asambljenë të përgjithshme të shoqërisë aplikues, duke treguar qartë aksionet dhe votat që ka secili prej aksionerëve;
- e) listën e aksionerëve që nuk kanë të drejtë vote, kur është e përshtatshme;
- f) listën e aktiviteteve të energjisë, të cilat janë në kontroll direkt ose indirekt nga shoqëria që ka paraqitur kërkesën për certifikim, duke treguar qartë mënyrën e kontrollit dhe të drejtat e përkatëse që ka kjo shoqëri;

- g) listën e aktiviteteve të energjisë elektrike, nëse kjo nuk është paraqitur qartësisht ne listën e aksionerëve, të cilët kanë kontroll direkt ose indirekt tek shoqëria që aplikon për certifikim, duke treguar qartë mënyrën e kontrollit dhe të drejtat e veçanta të tyre;
- h) listën e aktiviteteve të tjera të lidhura të energjisë (p.sh. grup shoqërisht që kanë lidhje), të cilat tregojnë qartë lidhjet që kanë me shoqërinë që aplikon dhe nivelin e bashkëpunimit të ndërsjellët;
- i) listën e licencave, lejeve dhe/ose autorizimeve të tjera të marra në aktivitetet e energjisë elektrike, referuan në nën paragrafët f), g) dhe h) të këtij paragrafi, për aktivitetet në sektorin e energjisë në Shqipëri dhe/ose vende të tjera, si dhe kopjet e noterizuara të këtyre licencave, lejeve dhe/ose autorizimeve;
- j) kopje të kontratës së aksionerëve ose aprovimin me shkrim nga administratori (drejtuesi kryesor) i shoqërisë që aplikon për certifikim që kjo kontratë nuk ka përfunduar;
- k) kopje të akteve të brendshme të cilat rregullojnë organizimin e punës të organeve kolegjiale të subjektit (bordit mbikëqyrës dhe/ose bordit drejtues) të shoqërisë që aplikon, nëse këto akte janë miratuar;
- l) lista e anëtarëve të organeve kolegjiale të subjektit (bordit mbikëqyrës dhe/ose bordit drejtues) aplikuese dhe të aktiviteteve të energjisë referuar në nën paragrafët f), g) dhe h) të këtij paragrafi;
- m) vendimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë që aplikon (duke përfshirë këtu të dhënat e votimit), sipas të cilit janë emëruar anëtarët e organeve kolegjiale të subjektit (bordit mbikëqyrës dhe/ose bordit drejtues);
- n) vendimin e asamblesë së përgjithshme të shoqërisë që aplikon ose të organit kompetent kolegjial (bordit mbikëqyrës dhe/ose bordit drejtues), sipas të cilit është emëruar drejtuesi i ekzekutiv (drejtuesi kryesor) i shoqërisë që aplikon;
- o) kopje të akteve dhe procedurave të brendshme që rregullojnë veprimtarinë e organeve të shoqërisë që aplikon, duke përfshirë këtu edhe ato që përcaktojnë të drejtat e tyre të përfaqësimit;
- p) informacion mbi drejtuesin ekzekutiv (drejtuesin kryesor) të shoqërisë që aplikon dhe punonjësit e tjerë të caktuar me kompetenca në funksione administrative dhe organizative në shoqërinë që aplikon, apo persona të tjerë të cilëve u janë caktuar këto kompetenca me anë të një autorizimi (prokure), siç është:
 - (i) informacioni mbi kompetencat dhe funksionet e caktuara;
 - (ii) përshkrimi i veprimtarive të tjera profesionale dhe/ose komerciale;
 - (iii) deklaratat e interesave të cilat përmendin se këta persona nuk marrin pjesë në aktivitetet e shoqërive elektroenergjetik që kanë lidhje me prodhimin, shpërndarjen dhe ose/ose furnizimin me energji elektrike;
- q) kopje të akteve dhe procedurave të brendshme, të cilat parandalojnë nxjerrjen e informacionit privat ose informacionit të ndjeshëm tregtar tek aktivitete e shoqërive elektroenergjetik të prodhimit, shpërndarjes dhe/ose furnizimin me energji elektrike; dhe
- r) Informacion rreth punonjësve të shoqërisë që aplikon, të cilët vijnë nga aktivitete të shoqërive elektroenergjetik të prodhimit, shpërndarjes, dhe/ose furnizimit me energji elektrike (duke i përcaktuar qartë këto aktivitete të energjisë) gjatë

periudhës prej gjashtë (6) muajsh para paraqitjes së të dhënave të aplikimit për certifikim.

- s) Rregulloret, udhëzuesit, manualët që lidhen me organizimin, operimin, aktivitetin apo nen kontraktimin e shërbimeve;
- t) Inventarin e aseteve:
 - (i) Sistemet e transmetimit të energjisë elektrike në pronësi (përfshirë ato në ndërtim);
 - (ii) Sistemet e transmetimit të energjisë elektrike në vende të treta;
 - (iii) Sistemet e transmetimit të energjisë elektrike në pronësi të të tretëve dhe në përdorim nga aplikuesi;
 - (iv) Struktura e pronësisë mbi sistemet e transmetimit të energjisë elektrike (duke specifikuar % e aksioneve);
 - (v) Dokumentacioni i pronësisë dhe planimetritë e zyrave qendrore.
- u) Lista e autoriteteve publike që kanë kontroll direkt ose indirekt apo të drejta aksionere mbi aplikuesin (përshkruani formën se si ushtrohet kontrolli; nëse autoriteti publik ka kontroll dhe në ndërmarrje prodhuese dhe/apo furnizuese; ndërvarësinë legale dhe financiare);
- v) Dokumente të tjerë që aplikuesi i vlerëson relevant për procesin.
- w) Kopje të të gjithë marrëveshjeve tregtare apo financiare mes aplikuesit dhe ndërmarrjeve të gjenerimit/furnizimit të integruara vertikalisht;

(2) Në rast se shoqëria që aplikon është filial i një shoqërie të huaj të regjistruar sipas rregullave për aktivitetet tregtarë në Shqipëri, ajo duhet të paraqesë tek ERE dokumentet, të dhënat dhe informacionin e mëposhtëm:

- a) Dokumentet, të dhënat dhe informacion për shoqërinë e huaj, filiali i të cilës po aplikon për certifikim, ashtu si kërkohet në paragrafin (1) të këtij Neni; dhe
- b) Dokumente të filialit, si kërkohet në nen paragrafët a), o), p), q) dhe r) të paragrafin (1) të këtij Neni.

Neni 10

(Dorëzimi i dokumenteve, të dhënave dhe informacionit)

- (1) Të gjitha dokumentet, të dhënat dhe informacioni i kërkuar sipas Nenit 9 të Rregullores duhet të paraqiten tek ERE në gjuhën Shqipe dhe atë Anglezë me shkrim dhe në mënyrë elektronike.
- (2) Në çdo kohë gjatë procedurës së certifikimit, ERE dhe sipas rastit, Sekretariati mund të kërkojnë nga shoqëria që aplikon dhe/ose aktivitetet e tjera energjetike të lidhur, dokumente, të dhëna dhe/ose informacion shtesë për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike.
- (3) Shoqëria që aplikon ose operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike i certifikuar duhet të njoftojë ERE për çdo ndryshim tek dokumentet, të dhënat dhe/ose informacionet e paraqitura menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se pesë (5) ditë pasi ka ndodhur ndryshimi, dhe duhet të paraqesë dokumentet, të dhënat dhe informacionin e korrigjuar.

- (4) Aplikuesi paraqet kërkesën me shkrim sëbashku me dokumentacionin e përcaktuar në këtë rregullore, origjinal dhe/ose të noterizuar sipas rastit kur është e nevojshme.
- (5) Aplikuesi jep sqarimet dhe informacion shpjegues dhe afatet për kërkesat e mësipërme të cilat në momentin e aplikimit janë në proces kompletimi apo nuk janë relevante dhe të aplikueshme për aplikuesin apo kur i njëjti dokument ezauron më shumë se një kërkesë.
- (6) Në rastet kur procedohet për rishikimin/rivlerësimin të certifikimit ekzistues në fuqi, informacioni që paraqitet vlerësohet rast pas rasti dhe në përputhje me kërkesat e ERE dhe/apo sekretariatit.

KAPITULLI IV – PROCEDURA E CERTIFIKIMIT

Neni 11

(Procedurat që aplikohen për certifikim)

- (1) ERE do të certifikojë operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike bazuar në procedurat e vendosura në Nenin 58 të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe në këtë Rregullore.
- (2) Procedurat e përcaktuara në aktet ligjore të cilat rregullojnë procedurat e brendshme dhe organizimin e punës së ERE-s, do të aplikohen por pa ndikim tek paragrafi (1) i këtij Neni.

Neni 12

(Vendimi për certifikimin)

- (1) ERE do të miratojë certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike brenda një periudhe prej katër (4) muajsh nga data e marrjes së aplikimit dhe paraqitjes së plotë të të gjitha dokumenteve, të dhënave dhe informacionit, sipas kërkesave në Kapitullin III të kësaj Rregulloreje.
- (2) Pas përfundimit të periudhës së specifikuar në paragrafin (1) të këtij Neni, nëse nuk është miratuar ndonjë vendim formal nga ERE, certifikimi do të konsiderohet i dhënë bazuar në vendimin e heshtur nga ERE. Vendimi i shprehur qartë ose i heshtur hyn në fuqi vetëm pas përfundimit të procedurave të vendosura në Nenin 58 të Ligjit nr.43/2015, "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Rregullores.
- (3) Vendimi i shprehur qartë ose i heshtur për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike duhet të njoftohet në kohë Sekretariatit nga ERE, së bashku me informacionin që i përket këtij vendimi.
- (4) Brenda dy (2) muajsh pas marrjes së njoftimit referuar në paragrafin (3) të këtij neni, Sekretariati duhet të dërgojë opinionin e tij tek ERE për pajtueshmërinë me kërkesat e veçanta të caktimit dhe certifikimit të operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike. Në mungesë të një opinion nga Sekretariati brenda afatit të përcaktuar në këtë

dokument, Sekretariati do te konsiderohet se nuk ka kundërshtime për vendimin e marrë nga ERE.

- (5) Brenda dy (2) muajsh pas marrjes së opinionit të Sekretariatit, ERE do të miratojë vendimin përfundimtar në lidhje me certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike, duke marrë në konsiderate ne maksimum këtë opinion. Vendimi i ERE dhe opinionit i Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë duhet të publikohen së bashku.
- (6) Kur vendimi përfundimtar i ERE ndryshon nga opinionit i Sekretariatit, ERE duhet të sigurojë dhe të publikojë së bashku me vendimin arsyetimin themelore për vendimin e ndryshëm dhe duhet të informojë edhe Sekretariatit ne përputhje me rrethanat.
- (7) Vendimi përfundimtar i ERE për certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike dhe për materialet e tjera, te përmendura në këtë Nen, duhet të publikohen në Fletoren Zyrtare, në faqen e internetit të ERE dhe në pjesën/seksionin e përcaktuar në faqen e internetit të Sekretariatit.
- (8) Me kërkesë të veçante të operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike të certifikuar ose me iniciativën e ERE, procedura e certifikimit mund te pasohet nga lëshimi i një licence të re për operatorin e sistemit të transmetimit te energjise elektrike ose modifikimi i licencës ekzistuese, sipas kërkesave, bazuar në procedurat e licencimit të përcaktuara në Rregullat e Licencimit të miratuara nga ERE.

Neni 13

(Certifikimi në lidhje me vendet e treta)

Procedura e certifikimit në lidhje me vendet e treta, sipas rastit kur operatori i sistemit të transmetimit te energjise elektrike ose, pronari i rrjetit të transmetimit te energjise elektrike kontrollohet nga një person/persona nga një vend i tretë/ ose vende të treta, do të zbatohet sipas Nenit 11 dhe 12 të Rregullores duke marrë në konsideratë kërkesat e veçanta të përcaktuara në Nenin 59 të Ligjit nr.43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike".

Neni 14

(Rihapja e procedurës së certifikimit)

- (1) ERE, në bazë të kompetencave të saj për monitorimin e pajtueshmërisë së vazhdueshme të operatorit të caktuar të sistemit të transmetimit te energjise elektrike me kërkesat për pavarësinë dhe ndarjen e aktiviteteve, do të rihapë një procedurë certifikimi për të siguruar pajtueshmërinë në rastet kur:
 - a) Me njoftimin e Operatorit te Sistemit te Transmetimit te energjise elektrike, sipas nenit 64, të Ligjit nr. 43/2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike";
 - b) Me iniciativën e saj kur ka dijeni për një ndryshim të caktuar mbi të drejtat ose ndikimin tek Operatorit te Sistemit te Transmetimit te energjise elektrike mund të çojë në shkelje të kërkesave respektive për pavarësinë dhe ndarjen e aktivitetit te Operatorit te Sistemit te Transmetimit te energjise elektrike, ose kur ka arsye të besueshme që kjo shkelje mund të ketë ndodhur; ose
 - c) Me kërkesë të arsyetuar nga Sekretariati.

- (2) Për qëllimin e këtij Neni, një procedurë certifikimi e rihapur nga ERE do të ndiqet sipas Neneve 11 dhe 12 të Rregullores.
- (3) Rihapja e procedurës së certifikimit do të rezultojë në një vendim të ri mbi certifikimin e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, i cili mund të pasohet me nxjerrjen e një licence të re për operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike, sipas paragrafit (8) të Nenit 12 të Rregullores.
- (4) Shkelja e dispozitave të Ligjit 54, 58 dhe 59 dhe atyre në këto rregulla dhe mosparaqitja e informacionit sipas përcaktimeve të kësaj rregullore e bën certifikimin ekzistues të pavlefshëm.

KAPITULLI V - DISPOZITAT PËRFUNDIMTARE

Neni 15

(Mbrojtja e informacionit privat)

- (1) Në rastet kur dokumentet, të dhënat dhe/ose informacioni, i paraqitur nga shoqëria aplikuese tek ERE ose Sekretariati, duhet të trajtohet si informacion konfidencial ose informacion i ndjeshëm tregtar, shoqëria që aplikon duhet të përcaktojë qartë se cila pjesë e dokumenteve, të dhënave dhe/ose informacionit duhet të konsiderohet si konfidencial ose si informacion i ndjeshëm tregtar.
- (2) ERE ose Sekretariati nuk e kanë detyrim që ti trajtojnë ato dokumente, të dhëna dhe informacione të paraqitura nga shoqëria që aplikon si informacione konfidenciale ose informacione të ndjeshme tregtarë, nëse shoqëria që aplikon nuk bën shënimet respektive që kërkohen nga paragrafi (1) i këtij Neni.
- (3) ERE ose Sekretariati do të kenë të drejtat e tyre për ta trajtuar çdo dokument, të dhënë dhe informacion si konfidencial ose si të ndjeshëm tregtar sipas zgjedhjes së tyre.
- (4) ERE ose Sekretariati do të mbrojnë informacionin konfidencial ose informacionin e ndjeshëm tregtar sipas kushteve dhe termave të parashikuara në ligjet në fuqi. Një informacion i tillë mund të publikohet vetëm në rastet kur kërkohet nga ligjet në fuqi.

Neni 16

(Detyrimet)

Shkelja e kërkesave të Rregullores ose çdo shkelje tjetër e ngjashme mund të shkaktojë detyrime për palën fajtoare sipas termave dhe kushteve të parashikuara në Nenin 107 të Ligjit nr.43/2015 date 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe/ose legjislacionin në fuqi.

Neni 17

(Ankimimi)

Vendimi i ERE sipas kësaj rregullore dhe /apo kontestimet në lidhje më të mund të trajtohen me negociim mes aplikuesit dhe ERE dhe/ose të ankimohet nga aplikuesi sipas

procedurave të përshkruara në Rregullat per Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE apo në gjykatën e cila ka kompetencën dhe juridiksionin për këto çështje (Gjykata Tiranës/Gjykata Administrative).

Neni 18

(Amendamente të rregullores)

Këto rregulla janë objekt rishikimi dhe ndryshimi me vendim të Bordit të ERE, në përputhje me Rregullat per Organizimin, Funksonimin dhe Procedurave të ERE.

Neni 19

(Hyrja në fuqi)

Këto Rregulla hyjnë në fuqi ne datën e miratimit nga ERE.

SHTOJCA

PYETËSORI PËR CERTIFIKIMIN E OPERATORIT TË SISTEMIT TË TRANSMETIMIT TE ENERGJISE ELEKTRIKE

I. Informacion i përgjithshëm:

(1) Ju lutem jepni të dhënat e mëposhtme të kontaktit:

a) Emrin dhe adresën e subjektit që do të certifikohet si operator i sistemit të transmetimit te energjise elektrike:

b) Adresën e internet ose website të operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike:

c) Emri, adresa, numri i telefonit, faksit dhe adresa e e-mailit dhe pozicioni që ka në shoqëri, personi i kontaktit te operatori i sistemit të transmetimit te energjise elektrike:

II. Ju lutem plotësoni Formularin e ndarjes së Pronësisë (Ownership Unbundling)

(1) Pronësia e sistemit të transmetimit nga operatori i sistemit të transmetimit te energjise elektrike – Neni 54 i Ligjit nr.43/2015 date 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Neni 9(1)(a) dhe 9(5) i Direktivës 2009/72/EC

a) Në lidhje me pronësinë e sistemit të transmetimit te energjise elektrike, ju lutem paraqisni analizat:

(i) Që specifikojnë të gjitha sistemet e transmetimit te energjise elektrike në pronësi të operatorit të sistemit të transmetimit te energjise elektrike në Shqipëri (po ashtu edhe ato që janë në ndërtim ose që nuk janë ndërtuar para datës 6 Tetor 2011), duke përfshirë linjat e interkonjeksioni dhe rrjetet e transmetimit te energjise elektrike te veçuara

(ii) Që specifikojnë sistemet e transmetimit te energjise elektrike, të cilat janë në zotërim (të plotë ose të pjesshëm) nga operatori i sistemit të transmetimit te energjise elektrike ne vendet e tjera të Komunitetit të Energjisë

(iii) Që tregojnë të gjithë pronarët e sistemit të transmetimit te energjise elektrike në fjalë duke specifikuar aksionet e secilit pronar, në rastin kur operatori i sistemit të transmetimit te energjise elektrike e zotëron këtë sistem pjesërisht:

(i).
(ii).
(iii).

- b) Informoni nëse operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike jep/merr me leasing ose me qira sistemet e transmetimit të energjisë elektrike për/nga ndonjë palë tjetër:

- c) Në rast se operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike është një sipërmarrje e përbashkët e cila i përket dy ose tre subjekteve të cilat zotërojnë sisteme transmetimi të energjisë elektrike në vende të ndryshme të Komunitetit të Energjisë, informoni nëse të gjitha palët e sipërmarrjes së përbashkët janë operatorë të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të miratuar sipas modelit të Operatorit të Pavarur të Sistemit (ISO) ose modelit të Operatorit të Pavarur të Transmetimit (ITO); ju lutem jepni emrin e këtyre shoqërive dhe tregoni statusin e OST:

(2) Kontrolli dhe zotërimi i operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike – Neni 54 i Ligjit nr.43/2015 date 30.04.2015 "për sektorin e energjisë elektrike" dhe Neni 9(1)(b)-(d), 9(2), 9(3) dhe 9(7) i Direktivës 2009/72/EC

- a) Kërkohej që operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike të mos kontrollohet nga ndonjë person i përfshirë në prodhimin ose furnizimin me gaz dhe/ose energji elektrike. Për të provuar zotërimin dhe kontrollin mbi operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike kërkohej një listë e shoqërive të cilat i përkasin të njëjtit grup. Për këtë arsye kërkohej informacioni i mëposhtëm:
- (i) Lista e të gjitha shoqërive/personave që kontrollojnë operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike në mënyrë direkte ose indirekte.
 - (ii) Listën e shoqërive që janë aktive në Shqipëri të cilat kontrollohen në mënyrë direkte ose indirekte:
 - nga këto palë
 - nga operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike
 - (iii) listën e shoqërive që kryejnë funksionet e prodhimit ose furnizimit në rast kur i njëjti person në mënyrë të drejtpërdrejtë ose jo ushtron kontroll ose ndonjë të drejtë mbi operatorin e sistemit të transmetimit të energjisë elektrike dhe këto shoqëri.

Për çdo deklaram të përmendur në pikat më sipër nga (i)-(iii) natyra dhe mënyra e kontrollit duhet të specifikohen (*p.sh.* të drejtat e votimit, të drejtat e vetos, mbajtja e shumicës së aksioneve, kompetenca për të emëruar anëtarët e bordit mbikëqyrës, bordit drejtues, ose organeve ligjore që përfaqësojnë subjektin, kontrollin *de facto* dhe *de jure*, kontrolli i vetëm ose kontrolli i përbashkët).

Informacioni që kërkohej në këtë pjesë mund të ilustruhet duke përdorur organogramën ose diagrame të ndryshme për të treguar strukturën e pronësisë dhe kontrollin e shoqërive. Ju lutem përfshini dispozitat e duhura ligjore dhe tregoni se cila pjesë e informacionit është kofidencial.

(i).

(ii).
(iii).

b) Në rast se një organ publik ushtron të drejtat e përshkruara në paragrafin (6) Neni 54 të Ligjit nr. 43/2015 datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Nenet 9(1)(b)-(d) të Direktivës 2009/72/EC, dispozitat e ndarjes së aktiviteteve kërkojnë të sigurojnë pavarësinë midis organeve publike që i ushtrojnë këto të drejta mbi aktivitetet e transmetimit, prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike. Prandaj në rast se një ose organe të ndryshme qendrore ose vendore (*sic janë Ministritë*) ushtrojnë këto të drejta, është e nevojshme të prezantohen mekanizma që e sigurojnë këtë pavarësi. Në lidhje me këtë ju lutem përgjigjuni pyetjeve më poshtë:

- (i) Ju lutem përshkruani shkurt nëse organet publike ushtrojnë kontroll të drejtpërdrejtë ose jo mbi ndonjë të drejtë tek aktivitetet e transmetimit, prodhimit dhe furnizimit të energjisë elektrike
- (ii) Në rast se organet qeveritare qendrore ose vendore i ushtrojnë këto të drejta për shoqëritë e përfshira në transmetim, gjenerim, prodhim, dhe furnizim të energjisë elektrike, ju lutem:
 - përshkruani në detaje se cili organ qeveritar i ushtron këto të drejta dhe mbi cilat subjekte
 - përshkruani shkurt ndërvaresitë organike (ligjore, financiare) midis këtyre organeve qeveritare
 - Përshkruani shkurt se si mundësohet që të drejtat e përshkruara në paragrafin (6) të Neni 54 të Ligjit nr.43/2015 datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Nenet 9(1)(b)-(d) të Direktivës 2009/72/EC, ushtrohen në mënyrë të pavarur përkatësisht në lidhje me sistemet e transmetimit të energjisë elektrike nga aktivitetet e gjenerimit, prodhimit ose furnizimit të energjisë elektrike

(i).
(ii).

(3) Detyrat e operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike – Neni 56 i Ligjit 43/2015 datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Neni 12 i Direktivës 2009/72/EC

a) Operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike duhet të funksionojë në rrjet sipas Neni 56 i Ligjit 43/2015 datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike" dhe Neni 12 i Direktivës 2009/72/EC. Ju lutem:

- (i) Përshkruani shkurt të gjitha detyrat që operatorit të sistemit të transmetimit të energjisë elektrike përmbush dhe jepni konkluzionet në përputhje me Nenin 56 i Ligjit 43/2015 datë 30.04.2015 "Për Sektorin e Energjisë Elektrike"

Elektrike” dhe Neni 12 i Direktivës 2009/72/EC. Dorëzoni të gjitha pjesët e dispozitave përkatëse rregullatorë (ligjet, kodet e rregullave, marrëveshjet midis shoqërive dhe rregulloret) duke treguar që operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike ka përgjegjësi të plotë për të përmbushur detyrat e përmendura më sipër dhe tregoni qartë pjesët përkatëse që mbështesin analizën

- (ii) Tregoni që në bazë të rregulloreve të zbatueshme ERE ka kompetencat, duke përfshirë këtu mundësinë për të vendosur gjoha parandaluese, të cilat ERE duhet ti zbatojë kur operatori i sistemit të transmetimit të energjisë elektrike nuk po i përmbush plotësisht ose pjesërisht detyrat dhe përgjegjësitë e specifikuar në Nenin 56 i Ligjit 43/2015 date 30.04.2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike” dhe Neni 12 i Direktivës 2009/72/EC.

(i): (ii):
